


Treguesit demografikë

Vjetore 2023 dhe tremujori I – 2024

Tiranë, më 13 maj 2024: Në vitin 2023, shtesa natyrore e popullsisë rezulton pozitive me 2.331 lindje më shumë se sa vdekje, duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2022, i cili regjistronte 690 lindje më shumë se sa vdekje.

Gjatë vitit 2023 lindën 23.617 foshnja, duke shënuar një rënie me 4,3 %, krahasuar me një vit më parë, ndërsa numri i vdekjeve ishte 21.286 persona, duke shënuar një rënie me 11,3 %, krahasuar me një vit më parë.


Fig. 1: Lindje, vdekje dhe shtesa natyrore e popullsisë, 2023



Gjashtë qarqe të vendit shënuan shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në gjashtë qarqet e tjera shtesa natyrore e popullsisë ishte negative.

Qarku me shtesën natyrore më të lartë ishte Tirana, me 3.548 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët ishte Korça, me 760 vdekje më shumë se sa lindje.


Fig. 2: Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, 2023



Numri i lindjeve për tremujorin e parë 2024 është 5.056, duke shënuar një rënie me 6,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2023, ndërsa numri i vdekjeve është 5.537, duke shënuar një rënie prej 5,2 %, krahasuar me tremujorin e parë 2023.

Shtesa natyrore e popullsisë, në tremujorin e parë 2024 regjistron 481 vdekje më shumë se sa lindje.

Fig. 3: Shtesa natyrore e popullsisë, T1 – 2024*




* Të dhëna janë paraprake

Në tremujorin e parë 2024, katër qarqe të vendit regjistrojnë shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në tetë qarqet e tjera, shtesa natyrore e popullsisë është negative.

Në tremujorin e parë 2024, qarku me shtesën natyrore më të lartë është Tirana, me 475 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët është Korça, me 217 vdekje më shumë se sa lindje.

Fig. 4: Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T1 – 2024*



* Të dhëna janë paraprake

Lindjet

Gjatë vitit 2023, tre qarqe të vendit shënuan rritje të numrit të lindjeve, ndërsa nëntë qarqe të tjera shënuan ulje, në krahasim me vitin 2022.

Qarku me numrin më të lartë të lindjeve ishte Tirana me 8.893 lindje, ndërsa qarku me numrin më të ulët ishte Gjirokastra me 393 lindje.

Rritjen më të madhe në përqindje të lindjeve, gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022 e kishte qarku i Korçës me 2,3 %, ndërsa rënien më të madhe e kishte qarku i Kukësit me 14,5 %.

Në tremujorin e parë 2024, të gjitha qarqet e vendit shënojnë ulje të numrit të lindjeve, në krahasim me tremujorin e parë 2023.

Qarku me numrin më të lartë të lindjeve është Tirana me 1.929 lindje, ndërsa qarku me numrin më të ulët është Gjirokastra me 74 lindje.

Rënien më të vogël në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të parë 2024, krahasuar me tremujorin e parë 2023 e ka qarku i Elbasanit me 2,0 %, ndërsa rënien më të madhe e ka qarku i Vlorës me 21,1 %.

Tab. 1: Lindjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2022	2023	Ndryshimi vjetor në %	T1 - 2023	T1 - 2024*	Ndryshimi tremujor në %
	Shqipëria	24.688	23.617	-4,3	5.424	5.056	-6,8
1	Berat	930	873	-6,1	203	164	-19,2
2	Dibër	1.187	1.064	-10,4	239	234	-2,1
3	Durrës	2.733	2.655	-2,9	608	556	-8,6
4	Elbasan	2.185	2.057	-5,9	440	431	-2,0
5	Fier	2.062	1.965	-4,7	433	421	-2,8
6	Gjirokastrë	392	393	0,3	81	74	-8,6
7	Korçë	1.269	1.298	2,3	301	282	-6,3
8	Kukës	819	700	-14,5	176	169	-4,0
9	Lezhë	1.208	1.082	-10,4	227	216	-4,8
10	Shkodër	1.656	1.478	-10,7	354	328	-7,3
11	Tiranë	9.089	8.893	-2,2	2.083	1.929	-7,4
12	Vlorë	1.158	1.159	0,1	279	220	-21,1
	**Të panjohur	0	0		0	32	

* Të dhëna janë paraprake

**Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon.¹

Vdekjet

Gjatë vitit 2023, të gjitha qarqet e vendit shënuan ulje të numrit të vdekjeve, në krahasim me vitin 2022.

Qarku me numrin më të lartë të vdekjeve ishte Tirana me 5.345 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të ulët ishte Kukësi me 521 vdekje.

Rënien më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë vitit 2023, krahasuar me vitin 2022 e kishte qarku i Fierit me 15,4 %, ndërsa rënien më të vogël e kishte qarku i Kukësit me 3,7 %.

Në tremujorin e parë 2024, një qark i vendit shënoi rritje të numrit të vdekjeve, në një qark nuk kishte ndryshim, ndërsa dhjetë qarqe të tjera shënuan ulje, në krahasim me tremujorin e parë 2023.

Qarku me numrin më të lartë të vdekjeve është Tirana me 1.454 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të ulët është Kukësi me 139 vdekje.

Rënien më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të parë 2024, krahasuar me tremujorin e parë 2023 e ka qarku i Gjirokastrës me 21,4 %, ndërsa rënien më të vogël e ka qarku i Tiranës me 2,6 %.

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim: <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/#tab4>

Tab. 2: Vdekjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2022	2023	Ndryshimi vjetor në %	T1 - 2023	T1 - 2024*	Ndryshimi tremujor në %
	Shqipëria	23.998	21.286	-11,3	5.839	5.537	-5,2
1	Berat	1.266	1.118	-11,7	303	287	-5,3
2	Dibër	947	877	-7,4	237	225	-5,1
3	Durrës	2.251	2.011	-10,7	569	547	-3,9
4	Elbasan	2.405	2.050	-14,8	564	530	-6,0
5	Fier	2.730	2.310	-15,4	644	584	-9,3
6	Gjirokastrë	836	731	-12,6	224	176	-21,4
7	Korçë	2.228	2.058	-7,6	571	499	-12,6
8	Kukës	541	521	-3,7	139	139	0,0
9	Lezhë	1.139	968	-15,0	278	262	-5,8
10	Shkodër	2.003	1.726	-13,8	478	414	-13,4
11	Tiranë	5.827	5.345	-8,3	1.417	1.454	2,6
12	Vlorë	1.825	1.571	-13,9	415	408	-1,7
	**Të panjohur	0	0		0	12	

* Të dhëna janë paraprake

** Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon.

Anekse

Tab. 3: Lindjet sipas tremujorëve

Nr.	Qarku	2023-1	2023-2	2023-3	2023-4	2024-1*
	Shqipëria	5.424	5.452	6.515	6.226	5.056
1	Berat	203	186	249	235	164
2	Dibër	239	266	279	280	234
3	Durrës	608	611	736	700	556
4	Elbasan	440	475	555	587	431
5	Fier	433	457	562	513	421
6	Gjirokastrë	81	86	118	108	74
7	Korçë	301	305	360	332	282
8	Kukës	176	174	177	173	169
9	Lezhë	227	253	312	290	216
10	Shkodër	354	335	393	396	328
11	Tiranë	2.083	2.027	2.457	2.326	1.929
12	Vlorë	279	277	317	286	220
	**Të panjohur	0	0	0	0	32

* Të dhënat janë paraprake

** Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon.

Tab. 4: Vdekjet sipas tremujorëve

Nr.	Qarku	2023-1	2023-2	2023-3	2023-4	2024-1*
	Shqipëria	5.839	4.950	5.338	5.159	5.537
1	Berat	303	273	270	272	287
2	Dibër	237	218	212	210	225
3	Durrës	569	421	521	500	547
4	Elbasan	564	491	505	490	530
5	Fier	644	531	566	569	584
6	Gjirokastrë	224	178	160	169	176
7	Korçë	571	510	492	485	499
8	Kukës	139	123	137	122	139
9	Lezhë	278	232	211	247	262
10	Shkodër	478	403	445	400	414
11	Tiranë	1.417	1.197	1.379	1.352	1.454
12	Vlorë	415	373	440	343	408
	**Të panjohur	0	0	0	0	12

* Të dhënat janë paraprake

** Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon.

Tab. 5: Shtesa natyrore e popullsisë sipas tremujorëve

Nr.	Qarku	2023-1	2023-2	2023-3	2023-4	2024-1*
	Shqipëria	-415	502	1.177	1.067	-481
1	Berat	-100	-87	-21	-37	-123
2	Dibër	2	48	67	70	9
3	Durrës	39	190	215	200	9
4	Elbasan	-124	-16	50	97	-99
5	Fier	-211	-74	-4	-56	-163
6	Gjirokastrë	-143	-92	-42	-61	-102
7	Korçë	-270	-205	-132	-153	-217
8	Kukës	37	51	40	51	30
9	Lezhë	-51	21	101	43	-46
10	Shkodër	-124	-68	-52	-4	-86
11	Tiranë	666	830	1.078	974	475
12	Vlorë	-136	-96	-123	-57	-188
	**Të panjohur	0	0	0	0	20

* Të dhënat janë paraprake

** Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve/vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja/vdekja mungon.

Tab. 6: Shtesa natyrore e popullsisë

Nr.	Qarku	2022	2023
	Shqipëria	690	2.331
1	Berat	-336	-245
2	Dibër	240	187
3	Durrës	482	644
4	Elbasan	-220	7
5	Fier	-668	-345
6	Gjirokastrë	-444	-338
7	Korçë	-959	-760
8	Kukës	278	179
9	Lezhë	69	114
10	Shkodër	-347	-248
11	Tiranë	3.262	3.548
12	Vlorë	-667	-412

* Të dhënat janë paraprake

Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2023-2026.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe.

Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).